



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 i datës 24.01.2021 si dhe kërkesës së drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim Nr.01.030-4086 të datës 20.01.2022 Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet, grupi punues i cili do të punoj në monitorimin e implementimit të planit të veprimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal 2019 - 2023.

1. Valon Pacolli- Drejtor i Ekonomis dhe Zhvillimit , Kryesues,
2. Imri Semetishti, Drejtor për planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit , anëtarë,
3. Safete Amerllahu, Drejtoresh e Gjeodezisë dhe Kadastrit , anëtare
4. Gafurr Heterni, Zyra e kryetarit , anëtarë
5. Valdete Muji, Zyra e Kryetarit, anëtare

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Grupit punues

Grupi punues ka për detyrë të punoj në monitorimin e planit të veprimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal 2019 – 2023 si dhe hartimit të strategjisë në të cilën theksohet se plani i veprimit të strategjisë do të rishikohet në baza dy vjeqare në kuadër të monitorimit që përcaktohet me strategji, konformë dispozitave ligjore përkatëse dhe me të njëjtin ta njoftojë Kryetarin e Komunes.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen, Kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

1Nr. 030-4086
Lipjan, më 08.02.2022

